



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2020:188590

Datë: 28.09.2023

Numri i dokumentit: 04730957

P.nr.2647/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Albrim Kastrati, në lëndën penale të akuzuarit F. R. nga P., i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.5720/20 të datës 30.12.2020, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 13.09.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Lulzim Aliu, i akuzuari F. R. me mbrojtësin e tij sipas autorizimit av. Halit Shaljani, me datë 18.09.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 28.09.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F. R., i biri i B. dhe nëna L., e gjinisë G., i lindur me ..., në P., me vendbanim në L. U. U. në P., me numër personal ..., të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 08.08.2020, rreth orës 06:00, në shtëpinë e të pandehurit, në rrugën “H. P.” në O., policia gjatë zbatimit të urdhëresës nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për arrestimin dhe dërgimin në vuajtje të dënimit, tani të pandehurit dhe pasi që policia kanë hyrë në dhomën e fjetjes së të pandehurit, gjatë arrestimit kanë gjetur qese me substanca narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme 26.42 gram, të cilën substancë i pandehuri e ka poseduar pa autorizim.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9,10 par.1, 17 par.1, 21 par.1, 38, 39 par.1 nen par.1.2, 46 par 1 nen par 1.1, 47, 48 par 2, 49 par 1, 69, 70, 71 par.1 nen par.1.2 dhe 1.3, 72 dhe neni 269 par 1 të KPRK-së dhe neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 6, 358, 359, 360, 361 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurin F. R. e gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

- I. Ashtu që i përcakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 200 Euro të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse në periudhën verifikuese prej një (1) viti i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.
- III. Në bazë të nenit 269 par.1 të KPPRK-së konfiskohet substanca narkotike e llojit Marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 26.42 gram.
- IV. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, URDHËROHET asgjësimi i substancës së cekur në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP/II.nr.5720/20 të datës 30.12.2020, ndaj të akuzuarit F. R. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 13.09.2023, në prani të Prokurorit të Shtetit, Lulzim Aliu, të akuzuarit F. R. me mbrojtësin e tij av. Halit Shaljani, ku i akuzuari pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë në të ardhmen veprën penale, ka deklaruar se kam qenë përdorues i substancave narkotike dhe se tani nuk është më përdorues, është penduar për këtë veprim dhe i kërkon Gjykatës që të shqiptojë një dënim sa me të butë.

Pas deklarimit të akuzuarit, mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i tillë bëhet në mënyrë vullnetare pas konsultimit të mjaftueshëm të akuzuarit me mbrojtësin e tij dhe se i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë si dhe ky pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me provat dhe gjendjen faktike si ne aktakuzë, Gjykata konstatoj se i akuzuari e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i akuzuari është i vetëdijshëm për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë për të cilat është njoftuar nga Gjykata, si dhe te gjitha kërkesat nga neni 242 par. 2 të KPPRK-se janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të

akuzuarit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara si: Raporti fillestar i incidentit me numër 2020-AJ-0250, i datës 08.08.2020, raporti i policit hetues A. M. #..., i datës 08.08.2020, procesverbali mbi intervistimin e të dyshuarit i datës 08.08.2020, si foto dhe provat tjera që gjenden të bashkangjitura në lëndë, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, rrjedh se në veprimet e të akuzuarit F. R. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Rrethanë rënduese Gjykata nuk gjeti përveç rrezikshmërisë së këtyre veprave penale.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata në kuptim të nenit 42 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen veçanërisht llojin e njëjtit të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 €.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 361 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.2647/20 më datë 28.09.2023

Bashkëpunëtori Profesional

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Albrim Kastrati

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.